



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:128093  
Datë: 13.06.2024  
Numri i dokumentit: 05840320

**Ac.nr.997/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. D., me vendbanim në rr. “K. B.” nr.... në Pejë, të cilin me autorizim e përfaqëson M. K., avokat me seli në rr. “B. C.” nr...., në Pejë, kundër të paditurës “E.” SH.P.K, me seli në Pejë, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja e kompanisë A. A., me objekt të kontestit borxh, në vlerë prej 6,000.00€, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.664/19, datë 01.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës “E.” SH.P.K, me seli në Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.664/19, datë 01.12.2020, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.664/19, datë 01.12.2020, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: “I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR, kërkesëpapia e paditësit E. D. nga Peja, ashtu që DETYROHET e paditura “E.” SH.P.K, njësia punuese në Pejë, që paditësit E. D. nga Peja në emër të borxhit të papaguar për tferkoren e blerë nga paditësi të tipit “T.. SFD..., me numër karoserije A5 .. 1..-....0, t’i paguajë shumën prej 6.000€, me 8 % kamatë dukke filluar nga dita e ushtrimit të padisë me dt.24.02.2014, e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1.234 €, e të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ankesën e të paditurës ta aprovojë si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës me theksimet se aktgjykimi i ankimuar është i qartë, i thukët dhe profesional dhe i njëjti është i bazuar në prova, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet në tërësi e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi E. D. nga P., me datë 24.02.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës NPT "E." në Pejë, përmes së cilës ka pretenduar se i njëjti me datë 31.08.2013 i ka shitur të paditurit automjetin transportues të llojit T.- tfurkore 5 F D ... me çmim prej 6,000.00€, ashtu që e paditura e ka marrë tfurkoren në të njëjtën ditë mirëpo çmimin e shitblerjes ndaj paditësit nuk e ka paguar ashtu që paditësi përveç që nuk e ka marrë çmimin e shitblerjes i njëjti ka humbur edhe fitimin ditor që do të kishte mundur ta realizonte po ta kishte të njëjtin në posedim. Për këto arsye paditësi ka kërkuar me anë të padisë që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të borxhit t'i paguajë shumën prej 6,000.00€ me 3.5 % kamatë duke filluar nga data 31.08.2013 e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, fillimisht ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.145/14, datë 12.02.2016, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ndërsa Gjykata e Apelit të Kosovës të njëjtin e ka vërtetuar me anë të aktgjykimit Ac.1700/16, të datës 13.02.2019 pas ankesës së paraqitur nga ana e paditësit.

Ndaj këtij aktgjykimi, paditësi me datë 11.03.2019 ka paraqitur revizion të cilin Gjykata Supreme e Kosovës e ka aprovuar si të bazuar duke i prishur dy aktgjykimet dhe atë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë dhe lëndën e ka kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.664/19, të datës 01.12.2020, tani të ankimuar me ankesë me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë për shitblerje me datë 31.08.2013, të cilën edhe e kanë nënshkruar mirëpo e njëjta nuk është përmbushur vetëm nga e paditura pasi që e njëjta nuk ka paguar çmimin kushtues për tfurkoren lëndore që është objekt i kontestit. Ndërsa në anën tjetër shitësi-këtu paditësi e ka përmbushur obligimin e tij kontraktues, duke i'a dorëzuar tfurkoren të paditurës (bartjen e të cilës e ka bërë vetë e paditura). Bindja e gjykatës që të vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është forcuar edhe me dëgjimin e personave që e kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes, e cila është objekt i këtij kontesti siç janë: paditësi E. D. dhe zyrtari i të paditurës V. G.. Gjykata, gjatë vendosjes, në veçanti vlerësoi pretendimet e të paditurës se në barazimin e arritur me paditësin E. D., të lidhur për borxhet

që i ka pas paditësi ndaj të paditurës, është llogaritur edhe tferkorja lëndore, dhe se pretendimi i tyre është se bëhet fjalë vetëm për një tferkore të blerë nga paditësi, por të njëjtit nuk arritën të bindin gjykatën që të vendos ndryshe, ngase të gjitha provat e prezantuara nga e paditura dhe të administruara nga gjykata, vërtetojnë faktin se kjo tferkore që e ka përmendur e paditura se është futur në barazim, mban numrin e karoserisë AFD 1...-6..., dhe ka çmim kushtues prej 7.656€, e që janë tjetër, nga ajo që ceket në kontratën lëndore (*që gjendet në shkresat e lëndës*), ku numri i karoserisë dhe çmim kushtues janë tjerë ashtu sikurse edhe data e shitblerjes.

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat ligjore nga neni 245, paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhënien e Detyrimeve e lidhur me nenin 7 dhe 319 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Për kamatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së derisa për shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata kufizohet në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndron pretendimet ankimor i të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Në rastin konkret edhe Gjykatës së Apelit i rezulton e njëjta gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë ngase nga provat e administruara në shqyrtim kryesor por edhe nga vetë pohimi i të paditurës në përgjigje në padi është konstatuar fakti se e paditura dhe paditësi kanë lidhur kontratë të shitblerjes, me datë 31.08.2013 për mjetin ngarkues tferkor të markës T. ID..., e tipit 5F..., me nr. të shasisë A5F.-6..., për të cilin janë pajtuar që e paditura, paditësit t'ia paguajë shumën prej 6,000.00€. Gjykata provoj faktin se në mes palëve ndërgjyqësve ka ekzistuar marrëdhënia kontraktuese e shitblerjes, ku paditësi në cilësinë e shitësit ia kishte shitur blerësit- të paditurës tferkoren e lartcekur. Ky fakt është vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarit V. G., i dëgjuar në seancën e datës 28.10.2015 dhe 09.06.2020, i punësuar si menaxher i distribuimit tek e paditura, i cili ka deklaruar se në emër të të paditurës ka nënshkruar kontratën mbi shitblerjen e automjeteve ndërsa fakti se i njëjti ka deklaruar se *“atë tferkore e kemi pranuar si kompensim për çka aj ka marr mall në kompaninë E. dhe meqë aj nuk na ka paguar borxhin ne jemi dakorduar që për një pjesë të borxhit t marrim një fruktotre”* nuk mund të merret si i vërtetuar pasi që e paditura me asnjë provë përgjatë gjithë shqyrtimeve gjyqësore nuk ka arritur ta provoj faktin dhe nuk ka arritur ti ofrojë ndonjë provë materiale gjykatës së shkallës së parë se me paditësin të jetë kompensuar në ndonjë mënyrë tjetër për fruktoren e blerë sipas kontratës së shitblerjes dhe se e njëjta ta ketë përmbushur detyrimin financiar në raport me paditësin.

Në anën tjetër në shkresa të lëndës provohet fakti se e paditura ka paguar shumën prej 7,656.00 € për një tfurkore tjetër të cilën ia ka shitur paditësit dhe atë tfurkoren me numër AF.. 1..., e që dëshmohet përmes faturës tatimore me nr.1...5, të datës 11.12.2014, të cilin fakt e ka pohuar edhe paditësi në seancën e datës 29.09.2015 dhe nuk ka qenë kontestuese e mbi të gjitha kjo shumë nuk ka qenë edhe objekt kontesti në këtë çështje kontestimore, ndërsa për tfurkoren me numër të shasisë A5F.. 1..-6.... e cila është kontraktuar sipas kontratës me Nr.113/2019, të datës 31.08.2013, e paditura nuk ka ofruar prova për të argumentuar se ka përmbushur pjesërisht apo tërësisht këtë detyrimin kontraktues. E paditura ka ngritur pretendim se ka paguar për çmim të tfurkores, dhe ashtu siç është provuar fakti i tillë qëndron, mirëpo ajo pagesë i referohej tfurkores me një të dhëna tjera të shasisë, kurse për tfurkoren objekt kontesti, asnjë provë se ka pasur pagesë të kryer.

Kështu që nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykatës së shkallës së dytë i rezultoi i drejtë dhe i ligjshëm qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit si të bazuar. Për më tepër, as pala e paditura, e as ndonjë rrethanë tjetër, nuk evidenton ndonjë shkelje eventuale ligjore që do të mund të përmbanin veprimet e gjykatës apo provat e administruara nga ajo, andaj edhe Gjykata e Apelit, gjen bazë të mjaftueshme ligjore, që t'u besojë vlerësimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe konkluzioneve të dhëna lidhur me gjendjen faktike në përgjithësi.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë kualifikimin në harmoni me të drejtën materiale. Kjo për faktin se siç është cekur edhe më lartë, me prova konkrete është provuar fakti se e paditura nga paditësi ka blerë tfurkoren objekt i kontestit mirëpo e njëjta paditësi nuk ia ka paguar shumën e të hollave, të cilat tani paditësi e kërkon me kërkesëpadi si dhe është provuar fakti se paditura nuk i ka përmbushur detyrimet e dala nga kontrata e lidhur me paditësin.

Kështu, në vlerësim të gjendjes faktike të vërtetuar është detyruar e paditura që për shkak të mos përmbushjes së kontratës së shitblerjes, t'i paguaj paditësit çmimin e kontraktuar. Në kuptim të nenit 8 par. 1 të LMD-së *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*. Kurse neni 438 par. 1 rregullon se *“Me kontratën e shitjes detyrohet shitësi që sendin të cilin e shet t'ia dorëzojë blerësit dhe t'ia kalojë të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t'ia paguajë çmimin dhe ta pranojë sendin”*. Është evident fakti se në rastet e një kontrate me detyrime të ndërsjella, kur njëra nga palët kontraktore nuk përmbush detyrimet e saj, pala tjetër ka mundësinë e kërimit ose të përmbushjes së detyrimit, ose të zgjidhjes së kontratës. Përfundimisht, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar.

Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, nga edhe ka rrjedhur bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadija e paditësit në rastin konkret është e themeltë ndërsa ankesa e të paditurës në rastin konkret është e pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të të paditurës se tferkoren e kishte pranuar nga paditësit si kompensim për mallin që paditësi merrte, rezultoi i pa bazuar, ngase nuk kishte paraqitur asnjë mjet të besueshëm provues, se realisht ka ndodhur një rrethanë e tillë. Paditësi kishte paraqitur kontratën e shitblerjes përmes së cilës argumentonte raportin kontraktual, ndërsa në anën tjetër e paditura nuk arrinte të paraqiste një mjet provues që realisht do të dëshmonte rrethanën se ka pasur këmbim me mallin që paditësi kishte marrë tek e paditura. Së këndejmi, mbi bazën e të gjitha provave që ka administruar gjykata e shkallës së parë, gjendjes faktike të vërtetuar mbi bazën e atyre provave, në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe duhet të aprovohet. Neni 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, andaj gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse, siç edhe është vepruar në rastin kontestues.

Gjykatës së Apelit i rezulton si i drejtë vendimi i gjykatës së shkallës së parë edhe lidhur me vendosjen lidhur me kamatën vjetore prej 8 % nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë bazuar në nenin 382 par.2 të LMD-së i cili shprehimisht përcakton *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë edhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sa i përket gjykimit të shpenzimeve të procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar në përputhje me nenin 449 dhe 452.1 dhe 463 të LPK-së, lidhur me TA-në.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.997/2021, datë 13.06.2024**

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**